



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery		21.12.2021	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHTK	6253/2021		1/4



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A nr.945/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari Arben Mehmeti -anëtarë, si dhe Sabile Avdyli Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional-procesmbajtëse, sipas Aktgjykimit A.nr.990/2019 i datës 10.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative kanë shqyrtuar ankesën me numër protokolli 708/2019 të datës 11.02.2019 të parashtruar nga ankuesi

me adresë banimi Rr "De Rada"nr.1 Shtime, kundër organit të punësimit- Komuna e Shtimes, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 21.12.2021, mori këtë:

### V E N D I M

**I.Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër protokolli 708/2019 e datës 11.02.2019, e parashtruar nga ankuesi

**II.Shfuqizohet** Vendimi 02/1ANr.6 i datës 18.01.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Shtimes.

**III.Obligohet** Kryetari i Komunës së Shtimes që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimin të këtij vendimi, të bëjë anulimin e konkursit të datës 20.12.2018 për pozitën Zyrtar për Pylltari në Komunën e Shtimes, si dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga kjo procedurë.

**IV.Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,** duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Komuna e Shtimes, me datë 20.12.2018 ka shpallur konkursin me Nr.02-070/05-34767 për pozitën "Zyrtar për Pylltari 1" në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi. Më datë 10.01.2019 Komuna e Shtimes ka njoftuar ankuesin për mos përfshirje në listën e ngushtë për shkak të mungesës së kualifikimit sipas kritereve të konkursit.



I pakënaqur me njoftimin e datës 10.01.2019 për mos përfshirjen në listën e ngushtë për pozitën Zyrtar për pylltari I, ankuesi më datë 16.01.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Shtimes.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Shtimes më datë 18.01.2019 nxjerr Vendimin 02/IANr.6 me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit të datës 16.01.2019 me nr.02/070/05/1563.

Ankuesi kundër Vendimit 02/IANr.6 të datës 18.01.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Shtimes, më datë 11.02.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 708/2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 12.02.2019, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Shtimes. Komuna e Shtimes më datë 20.02.2019 ka dërguar në Këshill përgjigjen në ankesë me të gjitha shkresat e procedurës së zhvilluar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional, ndërsa pas zgjedhjes së pesë anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pas shqyrtimit të bazës ligjore, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në mbledhjen e katërt të mbajtur më datë 09.11.2020 nxjerr Vendim me Nr. 9/2020 me të cilin është vendosur që të gjitha ankesat e dorëzuara dhe ato të kthyera në rishqyrtim nga gjykata gjatë kohës se mosfunksionimit, do të shqyrtohen dhe vendosen nga Këshilli.

**Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokollit 708/2018 të datës 11.02.2019 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi 02/IANr.6 i datës 18.01.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Shtimes; Ankesë e datës 16.01.2019 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Shtimes; Vërtetimi i datës 27.12.2018 me numër protokollit 760/1; Vërtetimi i datës 27.12.2018 me numër protokollit 1051/1; Kontratë e datës 27.09.2012, Diploma e përgatitjes së lartë shkollore e datës 24.02.2009 në Fakultetin e shkencave të aplikuara në Universitetin e Prishtinës –Ferizaj; letër reference e datës 09.01.2019; kontratë pune e datës 02.07.2015; letër reference e datës 21.12.2018; kopja e konkursit; Njoftim për pezullimin e procedurës e datës 17.01.2019; Aktvendim për pezullimin e procedurës së rekrutimit i datës 20.12.2018; Fletëdorëzimi i datës 18.01.2019; Formulari për kërkesë apo ankesë i datës 15.02.2019; Lista e ngushtë e datës 10.01.2019; Raporti për përgatitjen e listës së shkurtër e datës 09.01.2019; Vendimi 02Nr.01 i datës 04.01.2019 për themelimin e Komisionit Përzgjedhës; Formularët Form.MAP-SHCK-05; Kërkesa për punësim e datës 26.12.2018 për

bashkë me dokumentet e kërkuara; Kërkesa për punësim e datës 31.12.2018 për

bashkë me dokumentet e kërkuara; Kërkesa për punësim e datës 31.12.2018 për

bashkë me

dokumentet e kërkuara; Kërkesa për punësim e datës 28.12.2018 për

bashkë me

dokumentet e kërkuara; Kërkesa për punësim e datës 26.12.2018 bashkë me dokumentet e kërkuara;

Kërkesa për punësim e datës 28.12.2018 bashkë me dokumentet e kërkuara; Kërkesa për punësim e

datës 28.12.2018 për bashkë me dokumentet e kërkuarap; Kërkesa për punësim e

datës 31.12.2018 për bashkë me dokumentet e kërkuara; Regjistri i aplikacioneve të

pranuara; Njoftimi i datës 12.12.2018; Autorizimi i MAP-it i datës 18.12.2018; Kërkesë e datës

11.12.2018 dhe Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 20.02.2019 me numër protokollit

884/2019 bashkë me shkresat e lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:



Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon që Komisioni Përzgjedhës gjatë zhvillimit të procedurës së rekrutimit për pozitën “Zyrtar për Pyltari” në Komunën e Shtimes është bërë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se kriteret themelore të konkursit për këtë pozitë kanë qenë:

- *Diplome Universitare pa përvojë pune, (shkollë e lartë së paku dy vite përvojë pune) në fakultetin ekonomik, juridik ose Administrat Publike;*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit se i ka plotësuar kriteret e konkursit dhe nuk është përfshi në listën e ngushtë është i qëndrueshëm, sepse në bazë të dëshmive që gjenden në dosje ka konstatuar se Komuna e Shtimes procedurën e rekrutimit për pozitën “Zyrtar për Pyltari” e ka zhvilluar në kundërshtim me nenin 28 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil i cili përcakton se “*Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijim :Arsimimi dhe kualifikimi profesional dhe përvoja e punës*”, sepse ankuesi Z. posedon Diplomën me nr.264 e lëshuar me datën 24.02.2009 nga Fakulteti i Shkencave Teknike të Aplikuara (Shkolla e Lartë Teknike-Ferizaj) në Universitetin e Prishtinës me të cilën dëshmohet se me datën 13.06.2000 i ka dhanë të gjitha provimet dhe ka këtë përvojë pune pas diplomimit: prej datës 01.10.2012 deri më datën 01.09.2015 në Kolegjin Universitar Humanistica, prej datës 01.07.2015 deri më 31.08.2015 në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Shtimes, prej datës 18.05.2017 deri me datën 14.12.2017 anëtar i Komisionit Komunal në Shtime.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Shtimes, me rastin e nxjerrjes së Vendimit 02/1ANr.6 të datës 18.01.2019, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse nuk ka arritur të vërtetoj drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmer veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Kolegjit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës  
Lënda A.nr.945/2021, 21.12.2021

Sabile AVDYLI

*Sabile Avdyli*  
Procesmbajtëse

Eshref SHABANI

*Eshref Shabani*  
Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit,
- Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative-gjyqtari Fisnik Nuli
- Kryetarit të Komunës së Shtimes;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Shtimes dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

